



Bazuar në nenin 35, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, dhe nenin 65, paragrafi 1, të Ligjit Nr.03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.77/16 gusht 2010), si dhe në pajtim me nenin 4, paragrafi 3, dhe nenin 125, paragrafi 4, të Ligjit Nr. 05/L-045 për Sigurimet (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 38/24 dhjetor 2015), Bordi i Bankës Qendrore, në mbledhjen e mbajtur më 28 shkurt 2020 miratoi këtë:

RREGULLORE PËR DËNIMET ME GJOBË PËR SIGURUESIT, NDËRMJETËSUESIT NË SIGURIME DHE TRAJTUESIT E DËMEVE NË SIGURIME

Neni 1

Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Kjo rregullore ka për qëllim të përcaktojë dënimet me gjobë që mund të shqiptohen nga BQK, në rastet kur institucionet dhe/ose individët që i përfaqësojnë, kanë shkelur Ligjin për Sigurimet dhe/ose aktet nënligjore në zbatim të tij.
2. Kjo rregullore aplikohet ndaj institucioneve të licencuara nga BQK-ja dhe individëve që i përfaqësojnë ato.
3. Kjo rregullore nuk aplikohet për drejtorët (anëtarët e bordit të drejtorëve) të kompanive amë, në rastet e degëve të siguruesve të jashtëm, degëve të ndërmjetësuesve të jashtëm në sigurime dhe degëve të trajtuesve të jashtëm të dëmeve.

Neni 2

Përkufizimet

1. Të gjitha termet e përdorura në këtë rregullore kanë kuptimin e njëjtë me termet e përkufizuara në nenin 3 të Ligjit nr. 05/L-045 për Sigurimet (në vijim: *Ligji për Sigurimet*) ose/dhe me përkufizimet si më poshtë për qëllimin e kësaj rregulloreje:
 - 1.1. **Shkelje** – nënkupton veprimin ose mos veprimin e siguruesit, në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit për Sigurimet dhe/apo akteve nënligjore në zbatim të tij, të miratuara nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (në vijim: BQK).
 - 1.2. **Sigurues** – nënkupton personin juridik të licencuar nga BQK për të ushtruar veprimtari të sigurimeve, duke përfshirë subjektin e varur ose degën e siguruesit të jashtëm.

- 1.3. **Ndërmjetësues në sigurime** – nënkupton personin fizik apo juridik i licencuar nga BQK-ja dhe i kontraktuar nga siguruesi për të ushtruar veprimtari të ndërmjetësimit në sigurime, duke përfshirë subjektin e varur ose degën e ndërmjetësuesit të jashtëm.
- 1.4. **Trajtues i dëmeve në sigurime** – nënkupton personin fizik apo juridik, të licencuar nga BQK, duke përfshirë subjektin e varura ose degën e trajtuesit të jashtëm të dëmeve, dhe të kontraktuar nga të siguruarit apo siguruesit për të kryer aktivitete të trajtimit/vlerësimit të dëmeve në sigurime.
- 1.5. **Institucioni** – nënkupton siguruesit, duke përfshirë subjektin e varur ose degën e siguruesit të jashtëm, ndërmjetësuesit e sigurime të organizuar si persona juridikë, duke përfshirë subjektin e varur ose degën e ndërmjetësuesit të jashtëm, si dhe trajtuesit e dëmeve në sigurime të organizuar si persona juridikë, duke përfshirë subjektin e varur ose degën e trajtuesit të jashtëm të dëmeve.
- 1.6. **Individët** – nënkupton drejtorët (nëse është e aplikueshme), menaxherët e lartë dhe/ose punonjësit e siguruesve, ndërmjetësuesve në sigurime, trajtuesve të dëmeve në sigurime, si dhe administratorët e përkohshëm në rastet kur është e aplikueshme .
- 1.7. **Aktuari** - nënkupton personin, i cili ka për detyrë kryesore llogaritjen e tarifave të primeve, provizioneve teknike dhe matematike, duke u mbështetur në metodat aktuaristike.
- 1.8. **Akt nënligjor** – nënkupton Rregulloret, Udhëzimet, Urdhëresat dhe Vendimet e lëshuara nga BQK.

Neni 3

Dënimet me gjobë për siguruesit

1. BQK-ja mund të shqiptojë dënime me gjobë ndaj siguruesit nga 3.000 (tre mijë) euro deri në 15,000 (pesëmbëdhjetë mijë) euro, për shkeljet si në vijim:
 - 1.1 dështimin për të siguruar dhe plotësuar kërkesat për kapital, sipas kërkesave të nenit 19, paragrafi 1, nenit 21, nenit 60 dhe nenit 61 të Ligjit për Sigurimet si dhe akteve nënligjore në zbatim të këtyre neneve;
 - 1.2 shpërndarjen e dividendës, pa miratimin paraprak të BQK-së, në kundërshtim me nenin 66, paragrafi 1, të Ligjit për Sigurimet si dhe akteve nënligjore në zbatim të këtij neni;
 - 1.3 dështimin për të plotësuar kërkesat për aftësi pague (solvendë) dhe likuiditet sipas kërkesave të neneve 62 dhe 64 të Ligjit për Sigurimet si dhe akteve nënligjore për zbatimin e këtyre neneve;
 - 1.4 dështimin për të krijuar njësinë e auditimit të brendshëm ose për të kryer auditimin e brendshëm sipas kërkesave të nenit 77 të Ligjit për Sigurimet si dhe akteve nënligjore në zbatim të këtij neni;
 - 1.5 zotërimin e aksioneve, pa miratim paraprak të BQK-së, sipas kërkesave të nenit 35 të Ligjit për Sigurimet si dhe akteve nënligjore në zbatim të këtij neni;
 - 1.6 zhvillimin e veprimtarive tjera, pa u licencuar nga BQK, në pajtim me nenet 6 dhe 17 të Ligjit për Sigurimet si dhe aktet nënligjore në zbatim të këtyre neneve;

- 1.7 dështimin për të mbajtur kontabilitetin dhe dokumentacionin si dhe përgatitjen e pasqyrave financiare, sipas kërkesave të nenit 70 të Ligjit për Sigurimet si dhe akteve nënligjore në zbatim të këtij neni;
 - 1.8 dështimin për të raportuar në BQK, sipas kërkesave të nenit 71 të Ligjit për Sigurimet si dhe akteve nënligjore në zbatim të këtij neni;
 - 1.9 dështimin për të dorëzuar në BQK raportin dhe opinionet e aktuarit sipas kërkesave të nenit 72 të Ligjit për Sigurimet si dhe akteve nënligjore në zbatim të tij;
 - 1.10 dështimin për të publikuar raportin vjetor që përmban pasqyrat financiare të audituara të shoqëruara nga opinionet e auditorit të jashtëm, brenda afatit të përcaktuar sipas kërkesave të nenit 81, paragrafi 1, të Ligjit për Sigurimet si dhe akteve nënligjore në zbatim të këtij neni.
 - 1.11 dështimin për të bashkëpunuar me zyrtarët e BQK-së, sipas kërkesave të nenit 84, paragrafi 4, dhe nenit 86, paragrafi 4, të Ligjit për Sigurimet si dhe akteve nënligjore në zbatim të këtyre neneve.
2. Për shkeljet nga paragrafi 1 i këtij neni, BQK mund të shqiptojë dënim me gjobë për individët që e përfaqësojnë siguruesin, nga 500 (pesëqind) euro deri në 5.000 (pesë mijë) euro.
 3. Për shkelje tjera të dispozitave të Ligjit për Sigurimet, ligjeve tjera relevante si dhe akteve nënligjore, BQK mund të shqiptojë dënim me gjobë ndaj siguruesit nga 1.500 (një mijë e pesëqind) euro deri në 10.000 (dhjetë mijë) euro, kurse ndaj individëve që e përfaqësojnë siguruesin BQK-ja mund të shqiptojë dënim me gjobë nga 200 (dyqind) euro deri në 2.000 (dy mijë) euro.
 4. BQK mund të vendosë dënim me gjobë prej 1.000 (një mijë) euro për çdo ditë që shkelja vazhdon, nëse konstaton se një sigurues e ka shkelur ndonjë dispozitë të Ligjit për Sigurimet, akteve nënligjore në zbatim të tij apo çfarëdo kushti apo kufizimi të lëshuar nga BQK-ja. Kjo masë mund të shqiptohet vetëm, pasi BQK-ja paraprakisht e ka njoftuar dhe ka kërkuar nga siguruesi që ta ndalojë shkeljen respektive.
 5. BQK mund të shqiptojë dënim me gjobë për aktuarët e siguruesve, nga 500 (pesëqind) euro deri në 5.000 (pesë mijë) euro, në rastet e shkeljeve të dispozitave të Ligjit për Sigurimet që kanë të bëjnë me aktuarët si dhe akteve nënligjore në zbatim të tyre.
 6. BQK-ja mund të shqiptojë dënim me gjobë nga 500 (pesëqind) euro deri në 5.000 (pesë mijë) euro ndaj çdo personi tjetër që pengon dhe vështirëson mbikëqyrjen nga ana e BQK-së si dhe ndaj çdo personi, i cili me qëllim pengon administratorin e përkohshëm, të emëruar nga BQK-ja të marrë nën kontroll zyrat, librat e kontabilitetit, të dhënat dhe pasuritë tjera të siguruesit, nën administrim ligjor.

Neni 4

Dënimet me gjobë për ndërmjetësuesit në sigurime dhe trajtuesit e dëmeve në sigurime

1. Për shkelje të dispozitave të Ligjit për Sigurimet dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, BQK-ja mund të shqiptojë dënim me gjobë ndaj ndërmjetësuesve në sigurime dhe trajtuesve të dëmeve në sigurime të organizuar si persona juridikë nga 1.500 (një mijë e pesëqind) euro deri në 7.500 (shtatë mijë e pesëqind) euro, kurse ndaj individëve që i përfaqësojnë ndërmjetësuesit në sigurime dhe

trajtnesit e dëmeve të organizuar si persona juridikë, BQK-ja mund të shqiptojë dënim me gjobë sipas këtij paragrafi nga 200 (dyqind) euro deri në 2.000 (dy mijë) euro.

2. Për shkelje të dispozitave të Ligjit për Sigurimet dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, BQK-ja mund të shqiptojë dënim me gjobë ndaj ndërmjetësuesve në sigurime dhe trajtnesve të dëmeve në sigurime të organizuar si persona fizikë nga 200 (dyqind) euro deri në 2.000 (dy mijë) euro.
3. BQK-ja mund të shqiptojë dënim me gjobë nga 200 (dyqind) euro deri në 2.000 (dy mijë) euro ndaj çdo personi tjetër që pengon dhe vështirëson mbikëqyrjen e ndërmjetësuesit dhe trajtnesit të dëmeve nga ana e BQK-së.
4. BQK-ja mund të vendosë gjoba deri në 200 (dyqind) euro për çdo ditë që shkelja vazhdon, nëse konstaton se një ndërmjetësues në sigurime apo trajtnes i dëmeve e ka shkelur ndonjë dispozitë të Ligjit për Sigurimet, akteve nënligjore në zbatim të tij apo çfarëdo kushti apo kufizimi të lëshuar nga BQK-ja. Kjo masë mund të shqiptohet vetëm pasi BQK-ja paraprakisht e ka njoftuar dhe ka kërkuar nga ndërmjetësuesi në sigurime apo trajtnesi i dëmeve në sigurim që ta ndalojë shkeljen respektive.

Neni 5

Faktorët për vlerësimin e dënimeve me gjobë

1. Dënimet me gjobë shqiptohen me qëllim të ndëshkimit financiar të fajtorit në përputhje me shkallën e fajësisë dhe peshën e shkeljes si dhe të parandalimit të shkeljeve në të ardhme nga institucionet dhe/ose individët që i përfaqësojnë.
2. Dënimet me gjobe të shqiptuara nga BQK-ja nuk do të ndikojnë dhe nuk zëvendësojnë masat tjera administrative të përcaktuara me Ligjin për Sigurimet, të cilat mund të ndërmerren pavarësisht dhe pa u ndikuar nga dënimi me gjobë.
3. Gjatë vlerësimit të ashpërsisë së shkeljes do të merren parasysh faktorët si në vijim:
 - 3.1. Qëllimi – shkelja ka qenë e qëllimshme dhe është kryer si rezultat i mosrespektimit të kornizës ligjore në fuqi;
 - 3.2. Përfitimi – nëse institucioni, individët që e përfaqësojnë dhe/ose personat e tretë kanë përfituar nga shkelja;
 - 3.3. Përsëritja e shkeljes së njëjtë – nëse shkelja e njëjtë përsëritet nga institucioni ose individët që e përfaqësojnë;
 - 3.4. Shkeljet e kaluara – historia e shkeljeve të kaluara, veçanërisht kur ato janë të ngjashme me shkeljet në shqyrtim;
 - 3.5. Humbjet financiare – dëmi financiar që i është shkaktuar institucionit nga shkelja;
 - 3.6. Numri i shkeljeve – numri i shkeljeve nga ekzaminimi i fundit;
 - 3.7. Kohëzgjatja e shkeljes – kohëzgjatja e shkeljes specifike;
 - 3.8. Kohëzgjatja pas njoftimit – kohëzgjatja e shkeljes edhe pasi institucioni dhe/ose individi që e përfaqëson është paralajmëruar nga BQK;

- 3.9. Fshehja – fshehja e shkeljes;
- 3.10. Humbje tjera – dëme tjera (reputacioni, afarizmi në të ardhmen etj.) që i janë shkaktuar institucionit nga shkelja;
- 3.11. Dëmtimi i klientëve dhe palëve tjera – dëmi që i është shkaktuar klientëve dhe palëve tjera nga shkelja;
- 3.12. Bashkëpunimi me BQK – bashkëpunimi me BQK-në për të eliminuar apo zgjidhur problemet me kohë;
4. Rekomandimet për dënimet me gjobë do të iniciohen vetëm kur konstatohet se shkelja ka ndodhur. Dënimi me gjobë do të vlerësohet sipas faktorëve të përcaktuar në paragrafin 3 të këtij neni dhe do të llogaritet sipas përcaktimeve të nenit 6 të kësaj Rregulloreje.
5. BQK ndërmerret edhe masa tjera administrative ndaj institucioneve dhe/ose individëve që e përfaqësojnë institucionin, në pajtim me Ligjin për Sigurimet. Masat tjera mund të shqiptohen krahas ose veçmas dënimit me gjobë.

Neni 6

Llogaritja e dënimeve me gjobë

1. Dënimet me gjobë për institucionet e licencuara nga BQK-ja, të cilat operojnë në Republikën e Kosovës, do të llogariten sipas Shtojcës A të kësaj rregulloreje. Shtojca përmban tri forma, forma për institucion, forma për individët që i përfaqësojnë institucionet si dhe udhëzimet për plotësimin e tyre.
2. Plotësimi i shtojcës A do të bëhet nga zyrtari përgjegjës, i cili fillimisht do të rishikohet nga udhëheqësi i divizionit dhe drejtori i departamentit.
3. Në shtojcën A (tabela “Faktorët” dhe tabela “Bashkëpunimi me BQK” në formën 1 dhe/ose 2), janë përcaktuar notat e mundshme për secilin nga faktorët vlerësues të shkeljes përkatëse nga institucioni dhe/ose individi që e përfaqëson (kolona A).
Pas vlerësimit të shkeljes sipas faktorët vlerësues do të vendoset nota përkatëse për secilin nga faktorët (kolona B), e cila më pas do të shumëzohet me peshën e shkeljes (kolona C), dhe në fund llogaritet pikët dhe totali i tyre (kolona D = B x C).
4. Llogaritje e njëjtë bëhet edhe tek pjesa “Bashkëpunimi me BQK” ku varësisht nga gatishmëria e institucionit për eliminim të shkeljeve, caktohen pikët, të cilat e korrigjojnë totalin e fituar nga “Faktorët”.
5. Për të fituar gjithsej pikët për caktim të dënimit me gjobë, totali i pikëve nga tabela “Faktorët”, zbritet nga totali i pikëve nga tabela “Bashkëpunimi me BQK-në”.
6. Totali i pikëve të fituara sipas paragrafit 5 të këtij neni, do të jetë bazë për caktimin e lartësisë të dënimit me gjobë sipas përcaktimeve në shtojcën B të kësaj rregulloreje.
7. Në raste të caktuara, kur vlerësohet se dënimet mund të vështirësojnë gjendjen financiare të një institucioni, BQK-ja mund të lehtësojë apo mund të mos e shqiptojë dënimin me gjobë. Në raste të tilla BQK-ja, në vend të dënimit me gjobë, mund të shqiptojë masa tjera administrative të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

8. Pavarësisht përcaktimeve të këtij neni, sipas vlerësimit të saj, BQK-ja mund të shqiptojë dënime me gjobë edhe për raste tjera, që mund të jenë jashtë llogaritjeve dhe pikëve të fituara nga matricat A dhe B.

Neni 7

Procedura për shqiptimin e dënimeve me gjobë

Procedura e shqiptimit të dënimeve me gjobë do të bëhet në pajtim me kërkesat e Rregullores për Procedurat e Shqiptimit të Ndëshkimeve Administrative.

Neni 8

Shqyrtimet Gjyqësore

Subjektet ndaj të cilave është shqiptuar dënimi me gjobë sipas kësaj rregulloreje, kanë të drejtë të kërkojnë nga gjykata kompetente që ta shqyrtojë vendimin për gjobë brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga pranimi i vendimit, në pajtim me Ligjin për Sigurimet.

Neni 9

Shtojcat

Pjesë e kësaj rregulloreje janë Shtojca A Forma 1- Matrica për caktimin e dënimeve me gjobë- Institucioni, Forma 2- Matrica për caktimin e dënimeve me gjobë- Individidi që e përfaqëson Institucionin, Forma 3- Udhëzime për plotësimin e matricës dhe Shtojca B- dënimet me gjobë sipas pikëve.

Neni 10

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas miratimit të saj nga Bordi i Bankës Qendrore.

Flamur Mrasori

Kryetari i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

Shtojca A

Forma 1 - Matrica për caktimin e dënimeve me gjobë - Institucioni

Institucioni:

Shkelja:

Baza ligjore e shkelur:

Faktorët	Notat e caktuara për shkeljet					Nota (1-4)	Pesha	Pikët
	0	1	2	3	4			
	A							
Qëllimi	Nuk ka	Nuk aplikohet	Ka qenë dashtur të jetë në djeni	Nuk aplikohet	Qëllimi i pastër		5	0
Përfitimi	Nuk ka	Nuk aplikohet	Nuk aplikohet	Indirekt	Direkt		5	0
Përsëritja e shkeljes së njëjtë	Nuk ka	Nuk aplikohet	Nga ekzaminimi aktual	Nga ekzaminimi paraprak	Urdhër/vendim		4	0
Shkeljet e kaluara	Nuk ka	Jo e ngjashme	E ngjashme	E ngjashme > 2	E njëjtë		5	0
Humbjet financiare	Nuk ka	Minimum	Mesatar	Nuk aplikohet	Substanciale		4	0
Numri i shkeljeve	Vetëm një	Nuk aplikohet	2 - 5 shkelje	Nuk aplikohet	> 5		4	0
Kohëzgjatja e shkeljes	Nuk ka	< muaj	1 - 6 muaj	6 muaj - 1 vit	> vit		5	0
Kohëzgjatja pas njoftimit	Nuk ka	< muaj	1 - 6 muaj	6 muaj - 1 vit	> vit		5	0
Fshehja	Nuk ka	Nuk aplikohet	Nuk aplikohet	Qëllimisht	Në vazhdimësi		5	0
Humbje tjera	Nuk ka	Nuk aplikohet	Minimum	Mesatar	Substanciale		3	0
Dëmtimi i klientëve dhe palëve tjera	Nuk ka	Nuk aplikohet	Minimum	Mesatar	Substanciale		5	0
Gjithsej pikët 1							50	0

Bashkëpunimi me BQK	0	1	2	3	4	Nota (1-4)	Pesha	Pikët			
	A								B	C	D = B x C
	Korrigjimi i shkeljeve	Nuk ka	Përfunduar pas urdhrir/vendimit	Pjesërisht	Përfunduar pas zbulimit				Vullnetarisht para ekzaminimit	0	-5
Bashkëpunim i plotë	Nuk ka	Nuk aplikohet	Pjesërisht	Nuk aplikohet	Bashkëpunim të plotë	0	-5	0			
Gjithsej pikët 2								0			
Gjithsej pikët 1 dhe 2								0			

Shtojca A

Forma 2 - Matrica për caktimin e dënimeve me gjobë - Individu që e përfaqëson institucionin

Individi:

Pozita:

Institucioni:

Shkelja:

Baza ligjore e shkelur:

Faktorët	Notat e caktuara për shkeljet					Nota (1-4)	Pesha	Pikët
	0	1	2	3	4			
	A							
Qëllimi	Nuk ka	Nuk aplikohet	Ka qenë dashtur të jetë në djeni	Nuk aplikohet	Qëllimi i pastër	0	5	0
Përfitim	Nuk ka	Nuk aplikohet	Nuk aplikohet	Indirekt	Direkt	0	5	0
Përsëritja e shkeljes së njëjtë	Nuk ka	Nuk aplikohet	Nga ekzaminimi aktual	Nga ekzaminimi paraprak	Urdhër/vendim	0	4	0
Shkeljet e kaluara	Nuk ka	Jo e ngjashme	E ngjashme	E ngjashme > 2	E njëjtë	0	5	0
Humbjet financiare	Nuk ka	Minimum	Mesatar	Nuk aplikohet	Substanciale	0	4	0
Numri i shkeljeve	Vetëm një	Nuk aplikohet	2 - 5 shkelje	Nuk aplikohet	> 5	0	4	0
Kohëzgjatja e shkeljes	Nuk ka	< muaj	1 - 6 muaj	6 muaj - 1 vit	> Vit	0	5	0
Kohëzgjatja pas njoftimit	Nuk ka	< muaj	1 - 6 muaj	6 muaj - 1 vit	> Vit	0	5	0
Fshehja	Nuk ka	Nuk aplikohet	Nuk aplikohet	Qëllimisht	Në vazhdimësi	0	5	0
Humbje tjera	Nuk ka	Nuk aplikohet	Minimum	Mesatar	Substanciale	0	3	0
Dëmtimi i klientëve dhe palëve tjera	Nuk ka	Nuk aplikohet	Minimum	Mesatar	Substanciale	0	5	0
Gjithsej pikët 1							50	0

Bashkëpunimi me BQK	0	1	2	3	4	Nota (1-4)	Pesha	Pikët			
	A								B	C	D = B x C
	Korrigjimi i shkeljeve	Nuk ka	Përfunduar pas urdhrin/vendimit	Pjesërisht	Përfunduar pas zbulimit				Vullnetarisht para ekzaminimit	0	-5
Bashkëpunim i plotë	Nuk ka	Nuk aplikohet	Pjesërisht	Nuk aplikohet	Bashkëpunim të plotë	0	-5	0			
Gjithsej pikët 2								0			
Gjithsej pikët 1 dhe 2								0			

Shtojca A

Forma 3 - Udhëzime për plotësimin e matricës

Faktorët	Notat e caktuara për shkeljet					Nota (1-4)	Pesha	Pikët
	0	1	2	3	4			
Qëllimi	Nota 0 - Aplikohet në rastet kur shkelja nuk është e qëllimshme	Nota 1 - Nuk ka aplikim tek ky faktor	Nota 2 - Aplikohet në rastet e shkeljes, kur institucioni ka qenë dashur të jetë në dijeni se veprimi ose mosveprimi përbën shkelje	Nota 3 - Nuk ka aplikim tek ky faktor	Nota 4 - Aplikohet në rastet kur vlerësohet se institucioni ka pasur qëllim të pastër për shkelje		5	0
Përfitimi	Nota 0 - Aplikohet në rastet kur institucioni nuk ka përfitim nga shkelja	Nota 1 - Nuk ka aplikim tek ky faktor	Nota 2 - Nuk ka aplikim tek ky faktor	Nota 3 - Aplikohet në rastet kur institucioni në mënyrë indirekte ka përfituar nga shkelja	Nota 4 - Aplikohet në rastet kur institucioni në mënyrë direkte ka përfituar nga shkelja		5	0
Përsëritja e shkeljes së njëjtë	Nota 0 - Aplikohet në rastet kur nuk ka shkelje të njëjtë të përsëritur nga institucioni	Nota 1 - Nuk ka aplikim tek ky faktor	Nota 2 - Aplikohet në rastet kur shkelja është identifikuar në ekzaminimin aktual (për herë të parë)	Nota 3 - Aplikohet në rastet kur shkelja është identifikuar në ekzaminimin paraprak, dhe vazhdon akoma të jetë aktuale	Nota 4 - Aplikohet në rastet kur BQK ka lëshuar një urdhër/vendim lidhur me shkeljen e njëjtë		4	0
Shkeljet e kaluara	Nota 0 - Aplikohet në rastet kur nuk ka shkelje në të kaluarën nga institucioni	Nota 1 - Aplikohet në rastet kur shkelja nuk është e ngjashme me shkeljet e mëparshme	Nota 2 - Aplikohet në rastet kur shkelja është e ngjashme me shkeljen e mëparshme	Nota 3 - Aplikohet në rastet kur shkelja është e ngjashme dhe është përsëritur më shumë se 2 herë	Nota 4 - Aplikohet në rastet kur shkelja e njëjtë është e përsëritur		5	0
Humbjet financiare	Nota 0 - Aplikohet në rastet kur nuk ka humbje për institucionin nga shkelja	Nota 1 - Aplikohet në rastet kur humbja nga shkelja për institucionin është minimale	Nota 2 - Aplikohet në rastet kur humbja nga shkelja për institucionin është mesatare	Nota 3 - Nuk ka aplikim tek ky faktor	Nota 4 - Aplikohet në rastet kur humbja nga shkelja për institucionin është substancial		4	0
Numri i shkeljeve	Nota 0 - Aplikohet në rastet kur institucioni ka bërë vetëm një shkelje	Nota 1 - Nuk ka aplikim tek ky faktor	Nota 2 - Aplikohet në rastet kur institucioni ka bërë 2-5 shkelje	Nota 3 - Nuk ka aplikim tek ky faktor	Nota 4 - Aplikohet në rastet kur institucioni ka bërë më shumë se 5 shkelje		4	0
Kohëzgjatja e shkeljeve	Nota 0 - Aplikohet në rastet kur nuk ka shkelje nga institucioni	Nota 1 - Aplikohet në rastet kur kohëzgjatja e shkeljes ka qenë më e shkurtë se 1 muaj	Nota 2 - Aplikohet në rastet kur kohëzgjatja e shkeljes ka qenë nga 1 deri në 6 muaj	Nota 3 - Aplikohet në rastet kur kohëzgjatja e shkeljes ka qenë nga 6 muaj deri 1 vit	Nota 4 - Aplikohet në rastet kur kohëzgjatja e shkeljes ka qenë më e gjatë se 1 vit		5	0
Kohëzgjatja pas njoftimit	Nota 0 - Aplikohet në rastet kur nuk ka shkelje nga institucioni	Nota 1 - Aplikohet në rastet kur kohëzgjatja e shkeljes, pas njoftimit nga BQK, ka qenë më e shkurtë se 1 muaj	Nota 2 - Aplikohet në rastet kur kohëzgjatja e shkeljes, pas njoftimit nga BQK, ka qenë nga 1 deri në 6 muaj	Nota 3 - Aplikohet në rastet kur kohëzgjatja e shkeljes, pas njoftimit nga BQK, ka qenë nga 6 muaj deri 1 vit	Nota 4 - Aplikohet në rastet kur kohëzgjatja e shkeljes, pas njoftimit nga BQK, ka qenë më e gjatë se 1 vit		5	0
Fshehja	Nota 0 - Aplikohet në rastet kur nuk ka pas shkelje	Nota 1 - Nuk ka aplikim tek ky faktor	Nota 2 - Nuk ka aplikim tek ky faktor	Nota 3 - Aplikohet në rastet kur institucioni qëllimisht ka tentuar ta fshehtë shkeljen	Nota 4 - Aplikohet në rastet kur institucioni ka tentuar ta fshehtë shkeljen, edhe pas zbulimit nga BQK		5	0
Humbje tjera	Nota 0 - Aplikohet në rastet kur nuk ka ndikim tjetër përpos humbjes financiare	Nota 1 - Nuk ka aplikim tek ky faktor	Nota 2 - Aplikohet në rastet kur ndikimi tjetër përpos humbjes financiare, është minimal	Nota 3 - Aplikohet në rastet kur ndikimi tjetër përpos humbjes financiare, është mesatar	Nota 4 - Aplikohet në rastet kur ndikimi tjetër përpos humbjes financiare është substancial		3	0
Dëmtimi i klientëve dhe palëve tjera	Nota 0 - Aplikohet në rastet kur shkelja nuk ka shkaktuar dëmtim të klientëve dhe/apo palëve tjera	Nota 1 - Nuk ka aplikim tek ky faktor	Nota 2 - Aplikohet në rastet kur dëmtimi i klientëve dhe/apo palëve tjera është minimal	Nota 3 - Aplikohet në rastet kur dëmtimi i klientëve dhe/apo palëve tjera është mesatar	Nota 4 - Aplikohet në rastet kur dëmtimi i klientëve dhe/apo palëve tjera është substancial		5	0
						Gjithsej pikët 1		0
Bashkëpunimi me BQK dhe gatishmëria e institucionit për eliminimin e shkeljeve (faktorët lehtësues)	0	1	2	3	4	Nota (1-4)	Pesha	Pikët
Korrigjimi i shkeljeve	Nota 0 - Aplikohet në rastet kur nuk ka eliminim të shkeljeve	Nota 1 - Aplikohet në rastet kur eliminimi i shkeljeve është bërë vetëm pas urdhrir/vendimit të lëshuar nga BQK	Nota 2 - Aplikohet në rastet kur shkeljet janë eliminuar pjesërisht	Nota 3 - Aplikohet në rastet kur shkeljet janë eliminuar pas zbulimit të shkeljes	Nota 4 - Aplikohet në rastet kur shkeljet janë eliminuar vullnetarisht para identifikimit nga BQK-ja		-5	0
Bashkëpunim i plotë	Nota 0 - Aplikohet në rastet kur institucioni nuk ka bashkëpunuar plotësisht plotë me BQK-në	Nota 1 - Nuk ka aplikim tek ky faktor	Nota 2 - Aplikohet në rastet kur institucioni ka bashkëpunuar pjesërisht me BQK	Nota 3 - Nuk ka aplikim tek ky faktor	Nota 4 - Aplikohet në rastet kur institucionin ka bashkëpunuar plotësisht dhe shpreh gatishmëri të bashkëpunojë për eliminimin e shkeljeve		-5	0
						Gjithsej pikët 2		0
						Gjithsej pikët 1 dhe 2		0

Shtojca B - Dënimet me gjobë sipas pikëve

Pikët	Siguruesit*	Siguruesit**	Individët përgjegjës të siguruesit	Aktuarët	NS*** ose TD**** përsona juridik	Individët përgjegjës të NS ose TD përson juridik	NS ose TD përsona juridik
0 deri 15 pikë	diskutohet ose 3,000.00	diskutohet ose 1,500.00	diskutohet ose 500.00	diskutohet ose 500.00	diskutohet ose 1,500.00	diskutohet ose 200.00	diskutohet ose 200.00
16 deri 30 pikë	4,000.00	2,200.00	870.00	870.00	2,000.00	250.00	250.00
31 deri 45 pikë	5,000.00	2,900.00	1,240.00	1,240.00	2,500.00	400.00	400.00
45 deri 60 pikë	6,000.00	3,600.00	1,610.00	1,610.00	3,000.00	550.00	550.00
61 deri 75 pikë	7,000.00	4,300.00	1,980.00	1,980.00	3,500.00	700.00	700.00
76 deri 90 pikë	8,000.00	5,000.00	2,350.00	2,350.00	4,000.00	850.00	850.00
91 deri 105 pikë	9,000.00	5,700.00	2,720.00	2,720.00	4,500.00	1,000.00	1,000.00
106 deri 120 pikë	10,000.00	6,400.00	3,090.00	3,090.00	5,000.00	1,150.00	1,150.00
121 deri 135 pikë	11,000.00	7,100.00	3,460.00	3,460.00	5,500.00	1,300.00	1,300.00
136 deri 150 pikë	12,000.00	7,800.00	3,830.00	3,830.00	6,000.00	1,450.00	1,450.00
151 deri 165 pikë	13,000.00	8,500.00	4,200.00	4,200.00	6,500.00	1,600.00	1,600.00
166 deri 180 pikë	14,000.00	9,200.00	4,570.00	4,570.00	7,000.00	1,750.00	1,750.00
181 deri 200 pikë	15,000.00	10,000.00	5,000.00	5,000.00	7,500.00	2,000.00	2,000.00

* Sipas përcaktimeve në nenin 3, paragrafi 2 të Rregullores për dënimet me gjobe për siguruesit, ndërmjetësuesit në sigurime dhe trajtuesit e dëmeve në sigurime (3,000 - 15,000 euro)

** Sipas përcaktimeve në nenin 3, paragrafi 4 të Rregullores për dënimet me gjobe për siguruesit, ndërmjetësuesit në sigurime dhe trajtuesit e dëmeve në sigurime (1,500 - 10,000 euro)

*** Ndërmjetësues në sigurime

**** Trajtuesit e dëmeve në sigurime